



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni Parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.02.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 01.10.2018
2. Diskutime rreth vijueshmërisë së procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe veprimtarisë së bordit të përzgjedhjes së Anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Anëtarëve të Sekretariatit Teknik, që nga periudha e fundit e raportimit

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

-

E ftuar:

Aida Shehi – Drejtoreshë e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Hapim mbledhjen e Nënkomisionit Parlamentar “Për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit...

(Diskutime në sallë)

U lutem medieve të mbajnë qetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni punën tuaj, por edhe ne kemi detyrën tonë.

Atëherë, për sot ishte njoftuar mbledhja e Nënkomisionit Parlamentar “Për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave””, i njohur ndryshe si ligji për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit.

Deri tani ky nënkomision ka zhvilluar tri mbledhje. Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së fundit që kemi zhvilluar, asaj të datës 1.10.2018, ndërkohë si pikë të dytë të rendit të ditës kemi vendosur të diskutojmë rreth vijueshmërisë së procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe për veprimtarinë e bordit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarëve të Sekretariatit Teknik që nga periudha e fundit e raportimit.

Bashkë me ne sot është zonja Aida Shehi, drejtoreshë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme, si dhe kryetare e bordit të përzgjedhjes, e zgjedhur në këtë detyrë që në datën 26.04.2018.

Natyrisht, kolegët e dinë, por edhe për publikun, dua t’ju bëj me dije se ky nënkomision, në vijim të dëgjesave që ka pasur me zonjën Shehi dhe me një nga zëvendësministrat e Brendshëm, ka marrë një informacion që prej datës 16.11.2018 në lidhje me veprimtarinë e bordit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarëve të sekretariatit teknik.

Kuptohet, që nga nëntori deri sot, ka kaluar një kohë e gjatë, ndaj ne kemi ftuar zonjën Shehi të na shpjegojë se si ka vijuar veprimtaria e këtyre institucioneve që kanë filluar të ngrihen menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Vetingu në radhët e policisë do të fillonte gjithmonë pasi të ngrihej bordi përzgjedhës, ky të zgjidhte Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, i cili do të merret me vlerësimin e të gjitha gradave të larta në Policinë e Shtetit, dhe kjo punë do të mbështetet nga Sekretariati Teknik.

Gjithsesi, unë do të doja që t'ia jepja fjalën zonjës Shehi, që të na tregojë, në mënyrë të përmbledhur, lidhur me ecurinë për secilën prej këtyre strukturave. Ndërkohë, zonja Shehi do të na bëjë me dije se kur pritet të fillojë vetingu, cili do të jetë seti i parë i punonjësve të Policisë së Shtetit që do të vetohen, si dhe nëse Ministria e Brendshme, përkatësisht institucionet që janë zgjedhur për të ndjekur procedurën e vetingut në radhët e Policisë së Shtetit, ka infrastrukturën e duhur për ta zhvilluar veprimtarinë e tyre konform ligjit përkatës.

Zonja Shehi, fjala është për ju.

Aida Shehi – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare e komisionit!

Të nderuar anëtarë të këtij nënkomisioni, ashtu sikur u prezantua edhe nga kryetarja e komisionit, Ministria e Brendshme, me hyrjen në fuqi të ligjit, ka marrë masat përkatëse për ngritjen e strukturave për sa i përket fillimit dhe vijimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë, duke ngritur, së pari, bordin e përzgjedhjes, në të cilin, në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, parashikon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në këtë organ të disa përfaqësuesve dhe institucioneve të rëndësishme, duke nisur nga një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, që jam unë; një përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit, një nga Shërbimi Informativ Shtetëror...

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

T'i përmend me emra?

Atëherë, nga institucioni i Avokatit të Popullit është caktuar zoti Fatbardh Zenelaj, me detyrë sekretar i Përgjithshëm; nga Shërbimi Informativ Shtetëror është caktuar zoti Gjergji Semani, me detyrë drejtor pranë këtij Shërbimi; nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është caktuar zonja Ardita Shehaj, me detyrë drejtoreshë e Drejtorisë për të Drejtën e Informimit, ndërsa anëtari i pestë i këtij bordi është zonja Ardiana Hala, e cila përfaqëson Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi

Me caktimin e anëtarëve, në datën 26.04.2018, u bë edhe mbledhja e parë e këtij bordi, konstituimi i tij dhe marrja e vendimeve për të vijuar më pas me atë çfarë parashikonte edhe ligji.

Bëj me dije se në këtë mbledhje të parë, si dhe në mbledhjet e mëpasshme kanë qenë prezentë, pra e kanë ndjekur këtë proces, edhe partnerët ndërkombëtarë me përfaqësues nga PAMECA dhe ICITAP-i, të cilët e ndjekin këtë proces në vijimësi.

Në mbledhjen e parë u mor vendimi për të dërguar një shkresë zyrtare pranë ILDKPKI-së për të dërguar anëtarët përfaqësues, të cilët, sipas ligjit, përcaktohen nga ky institucion. Janë pesë anëtarë dhe dy zëvendësues. Gjithashtu, shkresa iu drejtua Rektoratit të Universitetit të

Tiranës për të përcaktuar dhjetë kandidaturat, mbi bazën e të cilave bordi i përzgjedhjes do të përzgjedhë pesë anëtarë për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, si dhe u mor vendimi për të shpallur thirrjen për paraqitje dhe shprehje interesi nga kandidatë për pesë vendet e tjera, sepse Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë, ku pesë janë nga ILDKPKI-ja, pesë nga pedagogët e përzgjedhur nga propozimet e rektoratit, si dhe nga pesë anëtarë të jashtëm që kanë shprehur interes.

Pas shprehjes së interesit, që është bërë më 27.04.2018 në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, kanë paraqitur interes për të aplikuar për pozicionet e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit konkretisht 52 persona, ndërsa për pozicionet e Sekretariatit Teknik kanë shprehur interes 54 persona.

Më tutje është mbajtur mbledhja vijuese, duke marrë në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur. Është vënë re që janë kërkuar dokumentacione shtesë për paqartësi për sa i përket vjetërsisë në punë dhe është mbetur në kontakt me këta aplikantë për të sjellë dokumentacionin shtesë. Më pas bordi i përzgjedhjes ka vendosur një procedurë, duke u konsultuar edhe me partnerët ndërkombëtarë, për vlerësimin e këtyre kandidaturave, duke vlerësuar dokumentacionin, duke vlerësuar karrierën e tyre, me pikat përkatëse, po ashtu edhe eksperiencën të ngjashme, të cilat do të ndihmonin në kryerjen e detyrës si anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Në fund kandidatët janë intervistuar nga bordi i përzgjedhjes për të krijuar edhe një kontakt me ta.

Në datën 20.06.2018 bordi i përzgjedhjes, pas kryerjes së intervistave, ka marrë vendimin dhe ka bërë renditjen e kandidaturave të paraqitura. Në diskutim edhe me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave, kanë vijuar diskutimet për sa i përket shpërblimit të këtyre pozicioneve në ushtrimin e detyrës së tyre, në rast se do të vijonte detyra. Tashmë është miratuar VKM-ja përkatëse nr. 14, e publikuar dhe hyrë në fuqi në datën 23.01.2019 “Për trajtimin financiar të anëtarëve të bordit përzgjedhës të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe të Sekretariatit Teknik pranë këtij komisioni”.

Në kushtet në të cilat u miratua kjo VKM, pra për shpërblimin dhe për të vënë në vijë punën e nisur, që nuk ka ndalur nga ana e bordit përzgjedhës, është mbledhur menjëherë bordi përzgjedhës për të vijuar dhe për të njoftuar personat e përzgjedhur si anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të Sekretariatit Teknik për t’i bërë me dije faktin e miratimit të kësaj VKM-je, që përcakton pagat për këto pozicione, si dhe njoftimin që janë përzgjedhur si anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ose të Sekretariatit Teknik.

Gjithashtu është vijuar puna për të marrë masa për sa i përket anës logjistike. Jemi në pritje nga momenti në moment, besoj brenda kësaj jave, që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Sekretariati Teknik i tij të fillojë nga puna.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Shehi, për informacionin që na dhatë deri në këtë moment!

Ftoj anëtarët e nënkomisionit të na sqarojnë momente të veçanta që kanë lidhje me ecurinë e punës së organeve të përzgjedhura për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit.

Fjala është për zotin Ndreu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam disa pyetje, por, në fakt, më shumë për të kuptuar, meqenëse është një ligj që ka pasur shumë diskutime jo vetëm jashtë, por edhe brenda organizatës së policisë. Çfarë problematike po has zbatimi i këtij ligji, sipas bordit të përzgjedhjes? A keni evidentuar ndonjë problematikë, që duket e vështirë për t’u kaluar? A mendoni se, sipas asaj që ky ligj është funksional, duke pasur parasysh edhe debatin që ne kemi bërë përpara, tani në zbatim mund të shikohen më mirë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shembull, ne kemi debatuar që Garda e Republikës të mos jetë e përfshirë, për shkak të specifikës së shërbimit që ka dhe të moskontaktit me atë që ne i themi ryshfet ose korrupsion, apo për ndarjen e strukturave të larta të drejtimit të oficerëve të policisë me ato të rolit bazë, që do të ishte një hap tjetër.

Këto dy pyetje kam: a ka ndonjë problematikë që lidhet me mënyrën si është konceptuar ligji ose me zbatimin e tij në praktikë dhe a keni pasur ndonjë shqetësim?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu, për pyetjet!

Po, zonja Shehi.

Aida Shehi – Faleminderit, zoti Ndreu!

Për sa i përket fillimit të këtij procesi, mund t’ju them se i vetmi problem që është hasur, të paktën që është konstatuar edhe nga bordi përzgjedhës, ka qenë miratimi pak me vonesë i aktit që sapocitova, pra i VKM-së për shpërblimin e këtyre organeve për të vijuar me punën e tyre.

Për sa i përket ecurisë së pjesës tjetër, nga ana e institucioneve përgjegjëse, që kanë qenë të detyruara për të mbartur deklaratimet e punonjësve, nuk është hasur ndonjë pengesë. Pra,

janë bërë deklaratimet dhe janë marrë me kohë nga ana e punonjësve, të cilët do t'i nënshtrohen këtij vlerësimi.

Aktualisht nuk ka pengesa të konstatuara, pasi ndoshta do të jenë pengesa që mund të dalin gjatë punës së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që do të ushtrojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deri në këto momente nuk ka ndonjë ngërç.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zonja Hoxha.

Elona Hoxha – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Shehi, për prezantimin!

Sigurisht, në këtë prezantim vlen të vlerësohet fakti që është zgjidhur ngërçi dhe tashmë i kemi të miratuar të gjithë anëtarët sipas...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e gjithë intervista e procesit të selektimit.

I pashë me vëmendje, sipas relacionit që ju keni, ndaj kjo vlen për t'u vlerësuar, së bashku me VKM-në për shpërblimet e punonjësve.

Pyetja që unë kam është: çfarë ndodh më pas? A është menduar tashmë qoftë puna konkrete, pajisja me zyra e të tjerë, pra pjesa që vjen më pas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi persona që tani kanë kaluar në procesin e seleksionimit sipas kriterëve të përcaktuara, kemi edhe pagat të alokuara për ta. Çfarë është konkretisht, sepse mendoj që ne jemi të vonuar dhe duhet shtyrë që ky proces të ndodhë sa më shpejt?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Hoxha!

Po, zonja Shehi.

Aida Shehi – Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket pjesës më pas, nga ana e Ministrisë së Brendshme, si dhe nga partnerët ndërkombëtarë janë hartuar tashmë modularë për të kryer trajnimin e këtyre strukturave brenda javëve të para, pas konstituimit të këtyre organeve.

Gjithashtu, për sa i përket logjistikës, janë marrë masa për të filluar punën qoftë për sa u përket ambienteve, qoftë të gjitha pajisjeve që do të jenë të nevojshme për ushtrimin e detyrës nga këto komisione.

Për sa i përket organizimit, meqenëse ligji nuk ka parashikuar detajimin e procedurës, do të jetë vetë organi, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i cili do të përcaktojë një rregullore për sa i përket organizimit të mëtejshëm në detaje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Po, zonja Hoxha.

Elona Hoxha – Pikërisht për këtë e pata fjalën, që të mos krijohet vakum ndërmjet procesit të parë, pra fazës së parë të selektimit, që mori kohë të mjaftueshme, dhe pjesës së dytë të punës që ata duhet të bëjnë.

Mendoj se duhet të vihen në lëvizje mekanizma, që ky kalendar punësh dhe aktiviteteve do të vijojë të jetë në mënyrë organike dhe jo që të marrë më shumë kohë sa duhet. Ky mund të jetë një merak i ekzagjeruar nga ana ime, por thjesht e shikoj se ka diçka që ndoshta duhet përsheptuar. Gjithsesi, besoj se Ministria e Brendshme i ka të gjitha mundësitë për të pasur një proces të shpejtë zinxhir ashtu siç duhet.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Hoxha!

Fjalën e ka zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë mendoj që, për sa kohë është ezauruar trajtimi financiar, puna do të fillojë dhe shpresojmë që ritmet të jenë sa më të shpejta për ta zgjidhur këtë situatë, por ajo që më shqetëson dhe që dua ta ngre si pyetje është: nëpërmjet këtij projektligji është krijuar mundësia që shumë punonjës policie të rikthehen në detyrë, por problemi dhe ngërçi që unë mendoj, besoj se këtë mendim e kanë edhe kolegët, është afati dyvjeçar që i penalizon ata. Domethënë, është hapur mundësia...

Pyetja ime është: si do ta zgjidhni këtë problem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Në fakt...

Sadi Vorpsi – Është një pyetje...

Ermonela Felaj – ...pyetja juaj lidhet me ligjin “Për Policinë e Shtetit”, dhe besoj ideja ka të bëjë me faktin që ne u kemi dhënë të drejtë me ligj edhe personave që janë jashtë Policisë së Shtetit që duan të rikthehen në detyrë, të kenë të drejtë gjithashtu që me një kërkesë t’i nënshtrohen procesit të vetingut përpara se të hyjnë në radhët e Policisë së Shtetit. A mendoni se kjo do ta ngarkonte punën e organeve të vetingut në radhët e Policisë së Shtetit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A keni një ide të përafërt se sa mund të jetë numri i personave ose nëse deri tani ka kërkesa nga personat që janë jashtë radhëve të Policisë së Shtetit për t'iu nënshtruar vetingut?

Aida Shehi – Ju kërkoj ndjesë, por nuk e disponoj një numër të saktë lidhur me këto kërkesa. Besoj se do të merren të gjitha masat që kjo të realizohet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, sepse më tutje ky i fundit do ta kalojë fazën e tij në gradat e larta të vlerësimit dhe më pas do të ngrihen komisionet përkatëse, si: komisioni qendror, që do të shtrihet për të marrë në vlerësim të gjitha kërkesat, formularët e deklarimit nga punonjësit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se do të realizohet.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Shehi!

Nëse nuk ka pyetje të tjera nga kolegët deputetë, unë kam disa pyetje për të plotësuar kuadrin e pyetjeve që ata bënë. Dua të di, aktualisht që ne flasim, trupat e vlerësimit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit janë plotësuar të gjitha?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte pyetja e parë.

Ju thatë se jeni gati me ambientet. A mund të na informoni pak më shumë se cilat do të jenë ambientet ku këto trupa vlerësimi do të akomodohen dhe ku do ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe një pyetje tjetër. Natyrshëm, kuptohet se trupat e vlerësimit kanë nevojë për trajnim paraprak përpara se të fillojnë detyrën. Nuk besoj se është risi që procesi i vetingut në radhët e Policisë së Shtetit ishte dhe është një sipërmarrje e vështirë, në kuptimin e të gjitha energjive njerëzore që kërkohen për t'u angazhuar, por jo vetëm kaq, sepse, nga ana tjetër, është edhe një ngarkesë e madhe financiare, problem i cili më vjen mirë që është zgjidhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk zgjidhëm hapin e parë, që arritëm të merrnim konsensus edhe nga opozita për miratimin e ligjit për ngritjen e këtij nënkomisioni, zgjidhëm hapin e dytë për shpërblimin e punonjësve, që do të merren me vlerësimin kalimtar të punonjësve që janë pjesë e Policisë së Shtetit, tani ngelemi te hapi i tretë, që është edhe më thelbësori, në kuptimin që trupat vlerësuese trajnohen në kohën e duhur, pa krijuar vonesa në proces dhe vetingu fillon normalisht.

Pra, lidhur me këto tri pyetje dua të kem një informacion se si e keni parë ju nga detyra e kryetares së bordit të përzgjedhjes deri tani dhe sa besim keni që me zgjidhjen e këtyre

problemeve, që ishin më të rëndësishmet dhe që e kishin penguar, le të themi, ecurinë e procesit të vetingut deri tani. A do të kemi probleme të tjera? Si e gjykoni ju, pasi jeni më afër procesit? Natyrisht, ne jemi të gatshëm, por e kemi edhe detyrë për shkak të ligjit, që çdo muaj t'ju thërrasim për të kuptuar se si po shkon ky proces, njëkohësisht për të përfituar nga rasti, për të bërë me dije qoftë punonjësit e Policisë së Shtetit, që natyrisht janë të interesuarit e parë për këtë proces, qoftë edhe publikun se si po shkon ky proces.

Aida Shehi – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë, nëse janë plotësuar pozicionet, përgjigjja është pozitive. Po, janë plotësuar pozicionet për anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, si dhe të Sekretariatit Teknik. Po kryhen disa verifikime dhe së shpejti finalizohet.

Për sa i përket vendit ku do të lokalizohen si organe, jemi të gatshëm në të dyja pozicionet që janë në vlerësim: qoftë në Akademinë e Sigurisë, që është një mundësi, apo edhe pranë Gardës së Republikës; kjo është çështje ditësh.

Në vlerësimin tonë, javën tjetër starton puna e tyre. Domethënë, janë marrë masat, por është vetëm çështje vendimmarrjeje nëse do të jetë njëri ambient ose tjetri.

Për sa u përket trajnimeve, sikurse e thashë, duke vlerësuar rëndësinë e tyre, gjatë kësaj kohe është punuar edhe me partnerët ndërkombëtarë për të pasur module të gatshme që, në momentin kur ato do të fillojnë nga puna javën e parë, do të nisin menjëherë me trajnimet përkatëse. Besoj se kjo do të mbyllet si procedurë.

Ermonela Felaj – Trajnimet do t'i zhvillojnë me ekspertë ndërkombëtarë.

Aida Shehi – Po, me ekspertë ndërkombëtarë bashkë me institucionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Bashkë me institucionet që asistojnë policinë?

Aida Shehi – Po, bashkë me PAMECA-n dhe ICITAP-in, ku kryesisht modulet i ka përgatitur PAMECA, por trajnimet do të kryhen edhe në bashkëpunim me institucionet shtetërore, që do të kenë pjesën e tyre për të dhënë ndihmesën e tyre në këto trajnime.

Ermonela Felaj – Ndërkohë, një çështje tjetër, që e preku pak zonja Hoxha në pyetjen e saj, që është edhe kërkesë e ligjit, është që trupat e vlerësimit të Komisionit të Jashtëm, por edhe komisionet e tjera duhet të veprojnë mbi bazën e një rregulloreje, se natyrshëm ligji nuk mund të detajojë çdo aspekt teknik, procedural të kësaj veprimtarie. Në momentin që flasim, a ka një draftregullore për funksionimin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit?

Aida Shehi – Rregullorja është një akt, që do të nxirret nga vetë organi që do të krijohet. Është normale që do të asistohet, sepse partnerët ndërkombëtarë do ta ndjekin këtë proces gjatë gjithë vijimit të tij, pra nuk është se mbyllet në këtë moment.

Draftirregullore... Siç e thashë, ajo është një punë, e cila do të përcaktohet nga vetë komisioni. Pra, puna e parë e tyre do të jetë përcaktimi i vetë rregullores, ashtu siç edhe bordi i përzgjedhjes bëri përcaktimin e procedurës që do të ndiqte, sepse ligji nuk e parashikonte një gjë të tillë. Në fakt, ligji nuk ka parashikuar që të jetë një organ tjetër që t’i miratojë rregulloren ose statutin këtij organi. Në këto kushte, mbetet detyrë e vetë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, që do të asistohet nga partnerët, si dhe nga Ministria e Brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Hoxha për një ndërhyrje.

Elona Hoxha – Kam një pyetje të drejtpërdrejtë: ky komision ka filluar të paguhet?

Aida Shehi – Jo, e nderuar, nuk ka filluar ende të paguhet. Sikurse e thashë, vendimi ka hyrë në fuqi në datën 23 janar, ndërkohë që janë ndjekur këto procedura për njohjen dhe vijimin e tij, janë marrë dakordësitë. Personat e përzgjedhur janë në marrëdhënie pune edhe në pozicione të tjera, por në momentin kur organi do të konstituohet, që ndoshta do të përkojë me fundin e kësaj jave ose fillimin e javës tjetër, do të fillojnë edhe marrëdhëniet financiare.

Ermonela Felaj – E qartë.

Faleminderit, zonja Shehi, për të gjithë informacionin, si dhe për gatishmërinë tuaj për të qenë prezente, njëkohësisht edhe për t’a mbajtur gjatë kohës të informuar nënkomisionin parlamentar për zbatimin e ligjit, që lidhet me vetingun në radhët e Policisë së Shtetit!

Në fakt, dua t’ju falënderoj edhe në emrin e kolegëve që, pavarësisht seancave që ne i kemi pasur publike, edhe komunikimi ndërmjet nesh ka qenë i pandërprerë. Besoj se muajt në vijim do të kemi një mbledhje tjetër për të kuptuar se si keni ecur, ndërkohë që ju inkurajojmë të ecni fort në këtë proces, pasi është shumë e rëndësishme që ne të mbajmë premtimin publik që kemi bërë, por, mbi të gjitha, të kryhet një proces i drejtë dhe efektiv.

Faleminderit!

Duke falënderuar edhe kolegët për pjesëmarrjen dhe pyetjet, e konsideroj të mbyllur mbledhjen e sotme!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA